



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ)** sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me paragrafin 8 të nenit 21 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP) me datën 19.07.2024, merr këtë:

**VENDIM**

**Për shqiptimin e gjobës për kryetaren e subjektit politik të regjistruar**  
**SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA**

- I. Kryetares së subjektit politik SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA, znj. Duda Balje, në cilësinë e personit përgjegjës të subjektit politik, i shqiptohet gjoba në vlerë njëmijë (1,000) euro.
- II. Gjobat e shqiptuara ndaj personave përgjegjës të subjektit juridik, paguhen individualisht dhe jo nga mjetet financiare të subjektit juridik
- III. Znj. Duda Balje, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën totale të gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- IV. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën III të këtij vendimi, gjobat ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme nga Përmbaruesi Privat.
- V. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

**Arsyetim**

Subjekti politik SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA, është e regjistruar si parti politike në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga data 13.01.2020 dhe është subjekti politik i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, i cili përfiton mjete nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, në përputhje me nenin 9 të LFSP.

Sipas azhurnimeve të fundit të dorëzuara nga subjekti politik në Zyrë, znj. Duda Balje figuron si Kryetare e këtij subjekti politik.

Me datën 10.07.2024, Zyra në përputhje me autorizimet që dalin nga LFSP ka marrë vendim për shqiptimin e dy gjobave për subjektin politik SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA.

Me vendimin e Zyrës me numër protokollit 355/10.07.2024 SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA është gjobitur për shkeljen e nenit 8 të LFSP që definojnë qëllimet e përdorimit të mjeteve financiare



nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, pasi që subjekti politik në fjalë ka shpenzuar një shumë prej dymijë e tridhjetë (2,030) euro të cilat janë në kundërshtim me nenin 8 të LFSP. Shuma prej dymijë e tridhjetë (2,030) euro është ndarë në dy pagesa, njëra në vlerën njëmijë e tetëqind e pesëdhjetë (1,850) që është pagesë për Kolegjin ISPE për studimet master të anëtarit të kryesisë së SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA, Almir Veliji dhe pagesa tjetër për Olive Medical në shumë prej njëqind e tetëdhjetë (180) euro.

Nënparagrafi 1 i paragrafit 6 të nenit 21 të LFSP e definojnë që përdorimi i mjeteve të Fondit në kundërshtim me nenin 8 të LFSP paraqet shkelje dhe subjekti politik që kryen këtë shkelje gjohet në përputhje me dispozitat ndëshkimore të LFSP.

Sipas paragrafit 8 të nenit 21 të LFSP, nëse një subjekt politik është gjetur në shkelje të ndonjëres prej shkeljeve të përcaktuara në paragrafin 6 të nenit 21, gjohet nga njëmijë (1,000) euro deri në tremijë (3,000) euro u shqiptohen personave përgjegjës të subjektit politik në fjalë, nëse vërtetohet se shkelja ka ndodhur për shkak të veprimit ose mosveprimit të tyre.

Kryetarja e subjektit politik SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA znj. Duda Balje, në cilësinë e personit përgjegjës të subjektit politik të gjobitur për shkeljet e lartcekura, ka qenë e vetëdijshme për këto pagesa pra shkelja ka ndodhur me veprimin e saj.

Në përputhje me paragrafin 26 të nenit 25 të Rregullores 06/2024 për Menaxhimin dhe mbikëqyrjen financiare të subjekteve politike, gjohet e shqiptuara ndaj personave përgjegjës të subjektit juridik, paguhen individualisht dhe jo nga mjetet financiare të subjektit juridik.

**Nga sa u tha më lartë, përmes këtij vendimi, Zyra vendosi për shqiptimin e gjobës në vlerë prej një mijë (1,000) euro, për personin përgjegjës të subjektit politik SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA, znj. Duda Balje, sipas dispozitivit të këtij vendimi.**

Prishtinë, 19.07.2024

Drejtori i Zyrës



Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

- Kryetares së partisë politike SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA, znj. Duda Balje

**Këshilla juridike:** Personi përgjegjës i subjekti politik mund të iniciojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.